



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 553/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vodosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Menaxherit të Qendrës së Votimit (QV), Sabri Berisha 3038a në fshatin Gurbardhë komuna e Malishevës, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

I Pjesërisht aprovohet si e bazuar ankesa, ashtu që vërtetohet se në Qendrën e Votimit 3038a/02, ka pas parregullsi më rastin e votimit.

II REFUZOHEȚ si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për anulimin e votimit në Qendrat e Votimit 3038a/02, 3038a/01R dhe 3032a/04.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjektit politik LDK, me të cilën pretendohet se në QV-në 3038a fshati Gurbardhë ka pasur parregullsi të mëdha, ku iniciuesi i tyre ka qenë menaxheri i QV-së Sabri Berisha, në cilësinë e drejtorit të shkollës në këtë fshat, parregullsitë më të mëdha kanë qenë në VV 2 në të cilin një person ka votuar deri në 10 herë; Në QV 3038a/01r menaxhimi i votimit nga menaxherët ka qene zero ngase ka pasur prezencë të tepërt të njerëzve në objekt të votimit; si dhe ka munguar ndriçimi; ka pasur votim pa dokument identifikues. Në qendrën e votimit 3032a në fshatin Bajë komuna e Malishevës gjithashtu ka pasur parregullsi ngase ka munguar ndriçimi përgjatë kohës së mbrëmjes. Në ankesë po ashtu theksohet se deri në ora 16:30, kanë votuar 181 votues, ndërsa nga ora 16:30 deri në ora 19:00, personat: Fitim Rifat Berisha, Bekim Elmi Berisha, Bajram Ramadan Berisha, Jeton Ramadan Berisha, Milaim Bislim Berisha, Zeqir Tafil Berisha, Valon Berisha kanë votuar nga 10 herë, ndërsa Avdi Milazim Berisha, Shpejtim Fatmir Berisha dhe Argjend Sabit Berisha kanë votuar edhe pse kanë moshën nën 18 vjeç, fletëvotimet në të cilat nuk ishte shënuar subjekti politik, janë shënuar emrat e subjektit politik PDK.

PZAP-i, në kuptim 118.4 të LZP-së, i shqyrtoi pretendimet ankimore dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të theksuara në Akt gjykimin A.A.135/2010 të datës 23.12.2010, e pas vlerësimit të gjithë anshëm të shkresave të lëndës, gjeti se:

- ankesa është pjesërisht e bazuar.

Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (b) të LZP-së parasheh:

b) para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në rast të jashtëzakonshme të anuloj rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi dhe ta urdhëroj KQZ-në ti përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatin final.

PZAP-i gjen se parregullsitë në qendrën e numërimit 3038A/02R nuk mund të konsiderohen se kanë ndikim në rezultatin final të zgjedhjeve nga Lista Përfundimtare e Votuesve në këtë qendër të votimit del se janë 270 nënshkrime të votuesve prej të cilave PZAP vlerëson se vetëm 9 nënshkrime nga numri i përgjithshëm i votuesve të cilët kanë votuar (270), janë të dyshimta, andaj PZAP-i vlerëson se ky numër kaq i vogël i nënshkrimeve të dyshimta në asnjë mënyrë nuk mund të ketë ndikim në rezultatin final të zgjedhjeve, për të cilën arsyen Paneli vlerëson se është i pabazuar pretendimi ankimor për anulimin e votimeve në këtë qendër votimi. Po ashtu, PZAP konstatoi që Formulari i Përputhjes së të Dhënavë dhe Rezultateve si dhe Libri i Votimit nuk dokumentojnë shkeljet e supozuara në ankesë. Për më tepër paneli vlerësoi edhe pjesën tjeter të ankesës përkitazi me qendrën votimit nr 3038a/01R dhe 3032a/04 dhe gjeti se ato pretendime ankimore nuk janë të bazuara në fakte se ka parregullsi serioze me rastin e votimit në këto vendvitime. Në fakt edhe vet ankesa thekson se kanë ekzistuar tendencia që të votohet pa leje identifikimi por nuk është lejuar, se nuk ka pasur dritë të mjaftuar në vendvotim etj, pretendimet të cilat vlerësohen si të përgjithshme pa u sqaruar më saktësisht dhe më konkretisht për shkeljet e natyrës serioze përkitazi më procesin e votimit në këtë qendër.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 6 paragrafi 4 parasheh:

Panellet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie .

PZAP –i për arsyet e lartpërmendura gjen se ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar, andaj edhe vendosi si ne pikën 1. të dispozitivit, ndërsa lidhur më refuzimin e ankesës për anulim të votimeve vendosi si në pikën 2. të diapozitivit e ne kuptim te nenit 118.1 dhe pika 2 te LZP, si dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe procedurave te PZAP-it te dt. 17 nëntor 2010.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

A nr. 553/2010 më datën 23.12.2010.

Kryesuesi i Panelit
Muhammed Shala

Prishnë / Pristina
Diplomas

